



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017, për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-0260009/17 dt. 18.10.2017, të investitorit Ndërmarrja Publike Banësore nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të Ndërtesës me lokale afariste, si pjesë të pavarura funksionale, me etazhitet S+P+1, P+0 & P+1, në rrugën “Mark Sopi”, Lagjja “Pejton” në Prishtinë, dhe Raportit Final 09 Nr. 356-197976 dt. 12.04.2018 të Sektorit të Ndërtimit të Drejtorisë së Inspeksionit të Komunes së Prishtinës, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 30.07.2018 lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT **Ndërtesës me lokale afariste si pjesë të pavarura funksionale**

I. I LEJOHET investitorit Ndërmarrja Publike Banësore nga Prishtina, përdorimi i Ndërtesës me lokale afariste, si pjesë të pavarura funksionale, me etazhitet S+P+1, P+0 & P+1, e ndërtuar në kuadër të parcelës kadastrale nr. 7447-0 dhe 7356-0, ZK Prishtinë, sipas Aktvendimit të lejes ndërtimore 05 Nr. 351-6856 dt. 26.03.2013, të lëshuar nga kjo drejtori.

II. Ndërtesa me lokale afariste, si pjesë të pavarura funksionale, mund të përdoret, bazuar në Raportin për Inspektim Final 09 Nr. 356-197976 dt. 12.04.2018, të Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës, destinimit të përcaktuar në pikën I. të Aktvendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-6856 dt. 26.03.2013 dhe dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, dhe e njëjta mund të përdoret/shfrytëzohet nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

III. Kjo Certificate do të shërbejë edhe për regjistrimin e ndërtesës-lokalet afariste në regjistrin kadastral.

A r s y e t i m

Sektori i ndërtimit i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës, përmes shkresës “Akt përcjellës” 09 Nr.391/02-0084904/18 dt.11.04.2018, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, në kuadër të së cilës ndodhet “Raporti Final” 09 Nr. 356-197976 të datë 12.04.2018, përpiluar nga komisioni për shqyrtimin e kërkesave të inspektimit final të kësaj drejtorie.

Drejtoria e Urbanizmit pas shqyrtimit të shkresës me raportin e lartcekur, dosjen e lëndës 05 Nr. 391/02-0260009/17 dt. 18.10.2017, konsultimin e rregullatives ligjore në fuqi nga aspekti i ndërtimit, inspektimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, konstatoi se:

Bazuar në kërkesën e investitorit, Ndërmarrjes Publike Banësore nga Prishtina, 05 Nr. 391/02-0260009/17 dt. 18.10.2017, kjo drejtori me aktin administrativ “Certificate e Përdorimit” 05 Nr. 391/02-0260009/17 dt. 23.10.2017, ka lejuar përdorimin me kusht të ndërtesës me lokale afariste me etazhitet dhe lokacion të përshkruar në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate, duke dhënë një afat 6 (gjashtë) mujor për eliminimin e vrejtyeve e përshkruara në Raportin e Inspektimit Final 05 Nr. 391-249988 dt. 17.10.2017, të Drejtorisë së Inspeksionit.

Investitori/Ndërmarrja Publike Banësore nga Prishtina, pas eliminimit të vrejtyeve të përshkruara në Raportin e Inspektimit Final me kërkesë i është drejtuar organit kompetent për Inspektim Final, gjegjësisht Sektorit të Ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit të Komunes së Prishtinës, i cili bazuar në mbikëqyrjen dhe verifikimin e puneve të zhvilluara mbi eliminimin e vrejtyeve të lartcekura, ka përpiluar Raportin për Inspektim Final 09 Nr. 356-197976 dt. 12.04.2018, me të cilin ka konstatuar se të

gjitha punet në ndërtimin dhe kompletimin e ndërtesës me lokale afariste janë në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor.

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, mbrojtje nga zjarri dhe punëve zejtare, 05 Nr. 391-249938 dt. 17.10.2017 dhe Raportin Final” 09 Nr. 356-197976 të datë 12.04.2018, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa-lokalet afariste mund të përdoren.

Në bazë të nenin 27 pika 3 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 14 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017, për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit për pjesët e pavarura funksionale, mund të bëhet pas përcaktimit të organit kompetent se, janë plotësuar të gjitha kërkesat e dokumentacionit ndërtimor, Kodit të ndërtimit dhe rregulloret teknike në fuqi, si dhe pas marrjes së masave të sigurisë për hyrjen dhe daljen në mënyrë të sigurtë të përdoruesve, në pjesët e pavarura funksionale, pa kaluar në përmes pjesëve që janë në ndërtim e sipër, konstatohet se janë plotësuar kushtet për paisje me certifikat përdorimi.

Andaj bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori vendosi që Ndërtesa me lokale afariste, si pjesë të pavarura funksionale, me etazhitet P+0 & P+1, mund të përdoret, gjegjësisht të lëshojë Certifikatën e Përdorimit të Ndërtesa me lokale afariste, si pjesë të pavarura funksionale

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-0260009/17 DT. 30.07.2018**

Zyrtari,
Bahtije Vllasaliu,

B. VLLASALIU

U.D. Udhëheqëse e sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi,

Mimoza Berisha Prestreshi

DREJTORI,
Ardian Olluri

